

# Bashkia e Tiranës, kontroll tregjeve për lëndët plasëse

Transmetuar më 23.11.2011 12:41

Like Confirm
 You like this. · Add comment · Admin Page · Insights · Error
 Chantal Van den Bossche likes this. Be the first of your friends to

Tiranë, 23 nëntor 2011, NOA - Bashkia e Tiranës nisi një aksion në të gjithë qytetin për kontrollin e shitjes së lëndëve me rrezikshmëri, veçanërisht ato plasëse dhe helmuese. Këto inspektime do të vijojnë në mënyrë periodike për të arritur një kontroll të plotë për standartet e sigurisë në tregëtimin e këtyre lëndëve, për të garantuar jetën e qytetarëve. “Aksioni është shtrirë në 4 pikat kryesore ku tregtohen këto produkte, siç është tregu çam, sheshi “Avni Rustemi”, tek Medreseja dhe më poshtë tek Stacioni i Trenit, 4 pika ku sistematikisht tregtohen këto produkte të rrezikshme, lëndë plasëse, ndezëse. Ne do të vazhdojmë kontrollet edhe për produkte të cilat kanë përbërje helmuese, kimike, insecticide, pesticide, në mënyrë që të rrisim standartin e shërbimit ndaj qytetarit të Tiranës dhe mbi të gjitha cilësinë dhe të sigurojmë jetën e tyre”, u shpreh Drejtori i Agjensisë për Mbrojtjen e Konsumatorit në Bashkinë e Tiranës, Geron Ibrahim. Aksioni po kryhet në bashkëpunim të plotë me strukturat e Zjarrfikësve si dhe të Policisë Bashkiake. Drejtori i Zjarrfikësve z Dilaver Laçi u shpreh se do të bashkëpunohet ngushtë me Bashkinë e Tiranës për të parandaluar çdo lëndë ndesëse e tregtuar jashtë kushteve të lejuara me ligj. “Së bashku me Policinë Bashkiake, Agjencinë për Mbrojtjen e Konsumatorit, ne do të vazhdojmë të kontrollojmë të gjithë bizneset. Pragu i vitit të Ri ka një rrezik të shtuar për fishekzjarrët dhe mjetet e tjera ndezëse. Për këtë arsye, në ditët në vijim do të ketë një kontroll më të rreptë nga ana e shërbimit Zjarrfikës dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, ndërkohë që edhe me Policinë Bashkiake ka një bashkëpunim



## Lajme të tjera




Sheshi “Skënderbej”, replikojnë Berisha e Blushi



Dhuna në Kosovë, MPJ: Cënim i paqes në rajon

Hëngri perime nga Fukushima, prezantuesi



Të rejat e fundit nga Procredit Bank

Të gjitha lajmet e ditës

Lexoni ...



**Agjencia Kombëtare e Lajmeve NOA** on Facebook

Like Confirm
 You like this. · Ad Page · Insights · I You like this. · Ad Page · Insights · I

9,527 people like **Agjencia Kombëtare e Lajmeve NOA**. 9,526 people like **Agjencia Kombëtare e Lajmeve NOA**.

buni
 Daut

Facebook social plugin

shumë të mirë”, tha Laçi.

a.q/NOA



vuan nga leuçemia



Blushi: Kufizim urgjent i borxhit publik



Vret burrin për xhelozë dhe e gatuan për drekë

## Komentoni

Emri

Komenti

Komento

## Komente

Ndalohen komentet me fjalë fyese, si dhe ato që nxitin diskriminimin e përhapjen e urrejtjes mbi baza nacionale, racore, fetare dhe mbi çfarëdo baze tjetër të paligjshme.

KREU | POLITIKË | KRONIKË | EKONOMI | SHËNDETI | EKSKLUZIVE | OPINION | KOSOVË | BALLKAN | KULTURË | SHKENCË | MAGAZINË |

SPORT

Agjencia Kombëtare e Lajmeve NOA, pjesë e InfoMedia.

Viti i pestë i transmetimit.

Ndalohet riprodhimi i plotë ose i pjesshëm i prodhimeve të NOA. Për të shfrytëzuar materialin e faqes,

jeni të detyruar të pranoni Kushtet e Përdorimit.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2007-2011 Agjencia Kombëtare e Lajmeve NOA.

Rreth NOA Marketing



Agjencia Kombëtare e Lajmeve NOA

Adresa: Blv. "Zogu i Parë"

Kompleksi "Qendra Tregtare Tiranë QTT"

info@noa.al



Dizenjimi dhe mirëmbajtja nga:

AvinDesign